



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 06, datë 12.07.2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:  
“NDËRTIMI LINJA TL, 110 KV, NËNSTACIONI SALLMONE – GJIRI I LALËZIT DHE  
SHTESË TRAKTI 110 KV NË NËNSTACIONIN SALLMONE”, ME VENDNDODHJE NË  
BASHKINË DURRËS DHE BASHKINË SHIJAK”


Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Ndërtimi Linja TL, 110 kV, Nënstacioni Sallmone – Gjiri i Lalëzit dhe shtesë trakti 110 kV në Nënstacionin Sallmone”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës dhe Shijak”, me zhvillues Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës do të lëshohet vetëm pas:
  - a) miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për pasuritë që do të shpronësohen;
  - b) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës dhe Bashkisë Shijak.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
LEDIA TOTA

